



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA			
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA			
Pranuar - Priljena Më/Dana 15-01-2024, yll/rd.			
Nr. i organit Org. broj	Numri/Broj	Shtojcë Prilog	Vlera Vrednost
01	410	103	68



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.1 dhe paragrafi 12.2, shkronja d, nenit 40, pika 2, shkronja h të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 36, paragrafi 36.2, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, pas shqyrtimit të propozimit të Kryetarit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur më datën 13.01.2024, merr këtë:

V E N D I M

Për shpalljen “Qytetar Nderi” i Komunës së Vitisë, ish-ambasadorin e SHBA-së në misionin e OSBE-së në Kosovë z. William G. Walker

Neni 1

Me këtë vendim, Kuvendi i Komunës së Vitisë shpall “Qytetar Nderi” të Komunës së Vitisë, ish ambasadorin e SHBA-së në misionin e OSBE-së në Kosovë z. William G. Walker

Neni 2

Titulli “Qytetar Nderi” i Komunës së Vitisë z. William G. Walker sipas këtij vendimi, do të ndahet nga Kryetari i Komunës, i cili autorizohet të përcaktojë formën e dekoratës, mënyrën e dhënies si dhe çështjet tjera, sa i përket organizimit të ndarjes së titullit në fjalë, për z. William G. Walker

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset kryetari i Komunës së Vitisë.

Neni 4

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 8 të Rregullores Nr.01/2016 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. z. William G. Walker
2. Zyrës së Kryetarit;
3. Shërbimit të Kuvendit dhe
4. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË
K R Y E S U E S I

Bekim Azizi

